

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Numri i regjistrimit themeltar 363
Data e regjistrimit 25.01.2022

Numri i vendimit 5727/6
Data e vendimit 27.07.2022

VENDIM

“Për depozitimin e akteve në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga gjyqtari i vetëm:

Dritan CAKA

Në Tiranë, sot më datë 27.07.2022, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen civile që i përket:

Kërkuese: “**Shoqata Rajonale e Futbollit Tiranë**”, me seli në Tiranë, Rr. “Liman Kaba”, pranë zyrave të FSHF, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ardian Haçi.

Objekti: Depozitimin e vendimeve Nr. 3, Nr. 5, Nr. 6, Nr. 7, Nr. 8, Nr. 9, datë 24.01.2022 të Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë.

Baza ligjore: Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jo-fitimprurëse” (i ndryshuar). Ligji nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.


Gjykata, pasi analizoi kërkesën dhe aktet që i bashkëlidhen asaj,

VËREN

Me vendimin nr. 5727, datë 19.01.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur regjistrimi si person juridik i “Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë” (SHRFT), e cila është krijuar për ushtrim veprimtarie përgjatë një periudhe kohore të pacaktuar.

Nga aktet bashkëlidhur kërkesës objekt shqyrtimi rezulton se më datë 24.01.2022, ora 15:00, është mbajtur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të “SHRFT”, e cila ka marrë vendimet që vijojnë:

1. Të miratojë rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme.
2. Të emërojë delegatët që verifikojnë procesverbalin e Asamblesë së Përgjithshme të “Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë” personat e mëposhtëm:
 - a. Ergys Sorra.
 - b. Kevin Xhafa.
 - c. Geldo Lilo.

- 
3. Të emërojnë anëtarët e Komisionit të Verifikimit me mandat 2 (dy) vjeçar personat e mëposhtëm:
 - a. Erjon Bushi.
 - b. Erion Stavri.
 - c. Ilir Bozhiqi.
 4. Të emërojnë vëzhguesit për Asamblenë e Përgjithshme të “Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë” personat e mëposhtëm:
 - a. Ilir Sinani.
 - b. Kujtim Pashaj.
 - c. Dritan Metaj.
 5. Të përjashtojë nga “Shoqata Rajonale e Futbollit Tiranë” subjektet e mëposhtëm;
 - a. Iliria Sh.a.
 - b. Akademia Zëre.
 6. Të miratojnë Buxhetin për vitin 2022 të “Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë”.
 7. Të miratojnë ndryshimet në statutin e shoqatës, sipas draftit bashkëlidhur.
 8. Të zgjedhë kryetar të “Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë” për një mandat 4-vjeçar, z. Krenar Alimehmeti.
 9. Të pranojnë si anëtar me të drejta të plota në “Shoqatën Rajonale të Futbollit Tiranë”, Shoqata “Don Bosco Academy”.
 10. Të hedhë në votim të fshehtë propozimet si kandidatë për delegatë të “SHRFT” në Asamblenë e Përgjithshme të FSHF.
 11. Të zgjedhë kandidatët për delegatë të “SHRFT” në Asamblenë e Përgjithshme të FSHF.
 12. Të zgjedhë kandidatët për delegatë të “SHRFT” në Asamblenë e Përgjithshme të FSHF, z. Krenar Alimehmeti, z. Fatjon Muhameti, z. Arbi Laci, z. Marko Pelinxhi, z. Ervin Canollari, z. Florian Mema.

Gjykata, pasi analizoi aktet që i bashkëlidhur kërkesës, vlerëson se duhet të pranojë depozitimin në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse të vendimeve të sipërcituar të marra në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të “Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë”, të datës 24.01.2022, ora 15:00.

Konkretisht, nga verifikimi i akteve rezultojnë se:

- Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të “SHRFT” është dërguar më datë 23.12.2021, gjë që vjen në përputhje me statutin e kësaj shoqate, duke iu lënë antarëve 30 ditë njoftim dhe të paktën 20 ditë për paraqitjen e autorizimeve për përfaqësuesit e tyre.
- Po në përputhje me kriteret e statutit, materialet e asamblesë iu janë dërguar antarëve më datë 13.01.2022.
- Në Asamblenë e “SHRFT” të datës 24.01.2022, ora 12:00, sipas listë-prezencës bashkëlidhur procesverbalit të mbledhjes, rezultojnë të kenë qenë të pranishëm fillimisht 65 delegatë, duke u plotësuar kuorumi i parashikuar nga neni 30 i statutit

të kësaj shoqate, ku përcaktohet se vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të jenë të vlefshme vetëm nëse në mbledhje është e pranishme shumica (më shumë se 50%) e anëtarëve me të drejtë vote.

Për këto arsye

Gjykata në bazë të neneve 39 – 53/1 të Kodit Civil, Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jo-fitimprurëse” dhe Ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jo-fitimprurëse”,

VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimn në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse të vendimeve Nr. 3, Nr. 5, Nr. 6, Nr. 7, Nr. 8, Nr. 9, datë 24.01.2022, ora 15:00, të Asamblesë së Përgjithshme të “Shoqatës Rajonale të Futbollit Tiranë”.
3. Urdhërohet Zyra e Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të bëjë regjistrimin përkatës të këtij vendimi.
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës kërkuese.

Tiranë, më 27.07.2022

GJYQTARI
- Dritan ÇAKA -



TABELA E SHPENZIMEVE GJYQËSORE PER CESHTJET CIVILE

Nr	Shpenzimegjyqësore	Pala që ka paraqitur/paguuar shpenzimin gjyqësor				Sasi	Cmim	Vlere
		Gjykata	Radites	I Raditur	P. tete			
	TarifeGjyqësore		1.000			1	1.000	1.000
	Shuma							1.000

[Shqiptarja.com]